



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 201, Datë 10.08.2022

MBI

SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 2 dhe 3 e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1439/2 prot., datë 08.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 170, datë 28.06.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE ka bërë njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 29.06.2022 dhe 30.06.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 13.07.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 636/4 prot., datë 30.06.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 636/5, datë 12.07.2022, dhe së fundi me nr. 636/7 prot., datë 05.08.2022, ka përcjellë dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se mbetet ende pa u plotësuar sa vijon:

- Kapitali financiar, i shprehur në vlera monetare, që vendos ortaku i vetëm i shoqërisë në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
 - Të dhëna për sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë shoqëria “Egantia “Hydropower” sh.p.k. gjatë secilit prej 5 (pesë) viteve të licencës.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e këtij afati rasti pas rasti, konkretisht:
- 3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.*
- Duke qenë se nga ana e shoqërisë është plotësuar pjesa më e madhe e dokumentacionit të kërkuar nga rregullorja, vlerësohet shtyrja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë asaj që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar tërësisht.
- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e paplotësuar brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Egantia Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e paplotësuar brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e vendimit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI